



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201400046/3

Tiranë ___/___/2014

Lënda : *Rekomandojmë fillimin e hetimeve në ngarkim të punonjësve të policisë të njësisë operacionale të Drejtorisë së Policisë të Qarkut Tiranë, për veprën penale të "Torturës" e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 86 dhe 25 të Kodit Penal.*

Drejtuar : **Drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor
Z. Petrit FUSHA**

Tiranë

I nderuar Zoti Fusha,

Në institucionin e Avokatit të Popullit ka bërë ankesë shtetasi S.A., i cili ndërmjet të tjerave shkruan se vëllai i tij A.A. është keqtrajtuar fizikisht nga punonjësit e Komisarariatit të Policisë Nr. 2 Tiranë gjatë arrestimit në datën 12.01.2014.

Për shqyrtimin e kësaj ankese në datën 15.01.2014 punonjësi ynë mori takim dhe pyeti me procesverbal shtetasin A.A., i cili ndodhej i arrestuar në ambientet e sigurisë në DPQ Tiranë. Sipas A., në datën 12.01.2014 në afërsi të TV "Vizion Plus" Tiranë, në momentin që ishte në një lokal i kanë shkuar disa persona civilë me kapuçë në kokë të cilët janë prezantuar si punonjës policie. Ata e kanë keqtrajtuar fizikisht atë duke e goditur me grushta, shqelma dhe qyta pistolete në kokë, në brinjë dhe kraharor, megjithëse ai nuk ka bërë asnjë lloj kundërshtimi ndaj tyre. Për shkak të dhimbjeve të forta ai ka humbur ndjenjat dhe është rrëzuar në tokë. Pas pak kohe është përmendur, është prangosur prej tyre dhe është dërguar në ambientet e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë e më pas në Komisariatin e Policisë Nr. 2 Tiranë. Në komisariat është pyetur dhe arrestuar në flagrancë për veprën penale të "prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe municioneve".

Në datën 13.01.2014 ai është dërguar në ambientet e sigurisë së DPQ Tiranë ku është vizituar dhe mjekuar nga personeli mjekësor i këtij organi. Ndërsa në datën 14.01.2014 meqënëse kishte ankesa për dhimbje është dërguar në Spitalin Ushtarak Tiranë ku ka bërë disa ekzaminime mjekësore. Në datën 15.01.2014 ai është dërguar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë për vlerësimin e masës së arrestimit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit personal. Gjykata ka caktuar ndaj tij masën e sigurimit personal "arrest në burg".

Nga ana jonë u bë këqyrja e kartelës mjekësore të shtetasit A.A. e cila ishte plotësuar nga mjekja e Seksionit të Shërbimit Shëndetësor dhe Psikologjik në DPQ Tiranë, si dhe libri i vizitave mjekësore të të arrestuarve e ndaluarve në ambientet e sigurimit të DPQ Tiranë. Nga këqyrja e këtyre dokumenteve rezulton se tek i arrestuari

A.A. janë konstatuar shenja të dhunës fizike si kontuzione e hematoma në kokë e në trup.

Nga pyetja e punonjësve të Komisarariatit të Policisë Nr. 2 Tiranë Elban Zavalani me detyrë specialist për hetimin dhe parandalimin e krimeve dhe OPGJ, i cili ka bërë arrestimin në flagrancë të shtetasit A.A., si dhe Loard Sallaku me detyrë shef i seksionit nr. 1 për hetimin e krimeve në këtë komisarariat, u informuam se ky organ ka patur informacione të mara në rrugë operative lidhur me një grup kriminal me në krye shtetasin A.A.. Sipas punonjësve të policisë, ky grup merrej me shitjen e armëve të zjarrit (pistoleta të pajisuara me silenciator). Nga strukturat e policisë është organizuar puna për verifikimin e informacionit dhe arrestimin në flagrancë të autorëve të dyshuar të kësaj veprë penale. Ndërmjet veprimeve të ndryshme policore dhe procedurale të kryera për këtë rast është kryer edhe vëzhgimi i tyre nga punonjësit njësisë operacionale të DPQ Tiranë. Në momentin e kapjes në flagrancë të njërit prej anëtarëve të këtij grupi, është urdhëruar kapja e shoqërimi në polici edhe i pjestarëve të tjerë të tij. Shef i seksionit nr. 1 për hetimin e krimeve në Komisarariatit të Policisë Nr. 2 Tiranë është njoftuar në telefon nga agjentët e policisë kriminale se shtetasi A.A. kishte kundërshtuar me dhunë punonjësit e policisë dhe kishte tentuar të largohej. Ndodhur në këto rrethana agjentët kanë përdorur forcë ndaj tij gjatë kapjes me qëllim shoqërimi në polici. Pas kryerjes së veprimeve procedurale me këtë grup kriminal janë arrestuar 6 persona, nga të cilët 4 për veprën penale të “prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe municioneve” dhe 2 për veprën penale të “moskallëzimit të krimit”.

Lidhur me identitetin e punonjësve të policisë që kanë mbajtur në vëzhgim dhe kanë kapur e shoqëruar shtetasin A.A., shefi i seksionit nr. 1 për hetimin e krimeve në Komisarariatit të Policisë Nr. 2 Tiranë z. Loard Sallaku na informoi se ata janë efektiv të njësisë operacionale të DPQ Tiranë, pjesë e strukturave operacionale të Policisë së Shtetit. Në bazë të nenit 121 të ligjit nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, punonjësve të këtyre strukturave u garantohet fshehtësia e identitetit për veprimtarinë operacionale. Ndodhur në këto kushte nuk mundëm të identifikonin e pyesnin ata rreth pretendimeve të të arrestuarit A.A. për keqtrajtimin fizik të tij prej tyre.

Meqënëse nga ana jonë u konstatuan shenja dhunë në kokën dhe në trupin e shtetasit A.A., me shkresën e datës 16.01.2014 i kërkuam Institutit të Mjekësisë Ligjore kryerjen e ekspertimit mjekoligjor të tij. Ndonëse ka kaluar një kohë relativisht e gjatë dhe megjithë interesimin tonë, deri tani nuk na ka ardhur akti i ekspertimit mjekoligjor të shtetasit A.A.. Sapo ai të na vijë do jua dërgojmë menjherë.

Në përfundim të shqyrtimit dhe hetimit administrativ të kësaj çështjeje dhe dokumentacionit të administruar nga ana jonë arritëm në konkluzionin se, ndaj shtetasit të arrestuar A.A. është ushtruar dhunë fizike nga punonjësit e policisë gjatë veprimeve të kryera me të në momentin e kapjes së tij me qëllim shoqërimi në organin e policisë. Kjo sjellje e bërë ndaj tij nga punonjësit e policisë së njësisë operacionale të DPQ Tiranë, duke e goditur me shqelma, grushta e qytë pistolete përbën një trajtim çnjerëzor. Si pasojë e kësaj dhune, ankuesit i janë shkaktuar dhimbje e vuajtje të rënda fizike duke humbur ndjenjat.

Sipas nesh, nga punonjësit e policisë janë konsumuar elementët e veprës penale të “Torturës” dhe për këtë arsye ky veprim duhet ndëshkuar rëndë. Dhuna e ushtruar nga punonjësit e policisë ndaj të arrestuarit është bërë me qëllim ndëshkimit e tij për shkak të veprimeve kriminale që ai dyshohej se kishte kryer dhe për të cilat është arrestuar. Ankuesit i është shkelur e drejta themelore e garantuar nga neni 25 i Kushtetutës dhe neni 3 i Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të Njeriut, *për t’iu mos u nënshtruar torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës.*

Për sa më sipër, bazuar në pikën 3, të nenit, 63 të Kushtetutës tonë ku thuhet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”; në nenin 21/ç,

të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", në të cilin thuhet se: "*Pas përfundimit të hetimeve, Avokati i Popullit..., i rekomandon prokurorisë të fillojë hetime në qoftë se vëren se është konsumuar figura e një veprë penale, ose të rifillojë hetimet e pushuara ose të pezulluara*", si dhe në vijim të përmbushjes së detyrimeve që burojnë nga "Protokolli Opsional i Konventës kundër Torturës dhe Ndëshkimeve të tjera Çnjerëzore dhe Degraduese (OPCAT)", i cili është ratifikuar nga Kuvendi ynë me ligjin nr. 9094 datë 03.07.2003,

REKOMANDOJMË:

Fillimin e hetimeve në ngarkim të punonjësve të policisë të njësisë operacionale të Drejtorisë së Policisë të Qarkut Tiranë, të cilët kanë marrë pjesë dhe kanë kryer veprime policore me të arrestuarin A.A., për veprën penale të "Torturës" e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 86 dhe 25 të Kodit Penal, të ndryshuar.

Për shqyrtimin e këtij rekomandimi dhe qëndrimin që do të mbani ndaj tij, të vihemi në dijeni brenda afatit ligjor prej 30 ditësh, konform nenit 22 të ligjit "Për Avokatin e Popullit".

Bashkëlidhur ju dërgojmë me cilësinë e provave dokumentet e më poshtme:

1. Ankesa e shtetasit S.A. bërë tek Institucioni i Avokatit të Popullit.
2. Procesverbali i pyetjes së shtetasit A.A., i mbajtur në datën 15.01.2014.
3. Procesverbali i pyetjes së shtetasit Loard Sallaku, i mbajtur në datën 17.01.2014.
4. Procesverbali i pyetjes së shtetasit Elban Zavalani, i mbajtur në datën 17.01.2014.
5. Kartela shëndetësore e shtetasit A.A..
6. Fleta e librit të vizitave mjekësore të të arrestuarve e ndaluarve në ambientet e sigurisë të DPQ Tiranë.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

**AVOKATI I POPULLIT
Igli TOTOZANI**

**Me Urdhër dhe Porosi
Nd/KOMISIONER**

Frederik PASKALI